



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.158..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21/ 11 / 2023

VENDIM

Nr. 42, datë 21 /11/2023

PËR

RREGULLOREN E SHFRYTËZIMIT, OPERIMIT, MIRËMBAJTJES, MONITORIMIT DHE SIGURISË SË DIGAVE TË SHFRYTËZUARA NGA BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.11.2023 mori në shqyrtim Rregulloren e shfrytëzimit, operimit, mirëmbajtjes, monitorimit dhe sigurisë së digave që shfrytëzohen nga Bashkia Tiranë të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik pranë Bashkisë Tiranë.

Rregullorja e përgatitur nga specialistët e kësaj Drejtorie e dorëzuar pranë KKDM rezultoi se nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e legjislacionit të mësipërm, kërkesat e KKDM për hartimin e rregullores përkatëse të shprehura në Vendimin e KKDM Nr. 3, datë 19.10.2020. Sic theksohet në nenin 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 të mësipërme, Rregullorja për Mirëmbajtjen, shfrytëzimin, vrojtimin dhe kontrollin e digës duhet të hartohet nga shfrytëzuesi i digës mbi bazën e rregullores dhe Udhëzimeve të KKDM dhe të miratohen në KKDM. Kjo rregullore duhet të përgatitet për cdo digë në funksion të specifikave që ka cdo digë në lidhje me treguesit teknikë të digës dhe Rezervuarit të krijuar prej saj, qëllimin që përdoret diga dhe rezervuari, gjëndjen aktuale të digës dhe rezervuarit, sistemeve të monitorimit të instaluar në cdo digë si dhe rrishtet që ka cdo digë. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratoj rregulloren e paraqitur për shfrytëzimin, operimin, mirëmbajtjen, monitorimin dhe sigurinë e digave të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë për arsye të mosplotësimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe udhëzimit përkatës të KKDM të përmendur me sipër.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratoj Rregulloren e Shfrytëzimit, Operimit, Mirëmbajtjes, Monitorimit dhe Sigurisë së digave të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndricimit Publik për arsye të mosplotësimit të kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe Udhëzimeve të dhëna në Vendimin e KKDM Nr.3, datë 19.10.2020.
- 2- Ti kërkoj Bashkisë Tiranë:
 - Përgatitjen e rregullores së shfrytëzimit, mirëmbajtjes, operimit dhe sigurisë për cdo digë të madhe që është në funksion dhe e rregjistruar në Rregjistrin e Digave të Mëdha pranë KKDM të shfrytëzuara nga Bashkia Tiranë, në përputhje me kërkesat e nenit 29 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 dhe vendimit të KKDM Nr. 03, datë 19.10.2020; Rregullorja duhet të përfshijë të dhënat teknike për cdo digë, qëllimin e përdorimit të digës dhe rezervuarit, rregulloren e monitorimit të digës sipas kërkesave të nenit 31 dhe 32 të VKM së mësipërme, Rregulloren për provat që duhet të kryhen në sistemet e shkarkimit përpara periudhës shirave, rregulloren e shfrytëzimit gjatë periudhës ujë shumë dhe ujëpakët në funksion të qëllimit të përdorimit të tyre, të dhënat për grupin e sigurisë së digës si dhe Planin e Gadishmërisë në rastet e Emergjencave civile për digat që kanë rrishtet të lartë në zonat urbane poshtë tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Informimin e KKDM në lidhje me zbatimin e kërkesave të mësipërme brenda muajit Mars 2024. Në rast të mosdorëzimit për miratim pranë KKDM brenda këtij afati, për personat përgjegjës do të zbatohen sanksionet e përcaktuara në nenin 11 të Ligjit Nr.8681, datë 02.11.2000 të dhënë me sipër
- Të dërgoj pranë SKDM informacionin në lidhje me digat e mëdha që kanë humbur funksionin kryesor për të cilin janë ndërtuar ose kupa e rezervuarit të krijuar prej tyre është mbushur me materiale të ngurta në atë shkallë që objekti ka humbur funksionin për të cilin është nëertuar. Ky informacion duhet të dorëzohet pranë SKDM brenda muajit Mars 2024

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI